

Deri te:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës “Fadil Sylejmani”

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës “Fadil Sylejmani”, nr.13-1317/2, nga mbledhja e mbajtur më datë 03.10.2019, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: **“Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale-Rasti i Kosovës”**, të kandidatës **Ma.sc.Adelina Rakaj**, komisioni në përbërje të: Prof. Dr. Afrim Osmani, Kryetar, Prof. Dr. Qebir Avziu, anëtar, Prof. Dr. Arta Bilalli, anëtare, Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar dhe Prof. Dr. Fatmire Lumani, Mentore, Këshillit Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës ia paraqet këtë:

RAPORT

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Informacione lidhur me lëndën e hulumtimit

Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale-rasti i Kosovës, është tema e cila trajtohet në këtë tezë të doktoratës. I pandehuri në procedurën penale është njëri ndër subjektet kryesore, ndaj të cilit edhe zhvillohet procedura penale. Krijimi i garancive juridike për një proces të rregullt penal mundëson që subjektet në procedurë të jenë të barabarta gjatë gjithë procesit penal me qëllim që një proces penal të mbyllet me sukses dhe pa shkelur asnjë garanci materiale dhe procedurale, që është e përcaktuar me kushtetutë, ligje dhe konventa ndërkombëtare.

Përmes trajtimit të pozitës së të pandehurit në disa dimensione, kandidatja ka arritur të zbërthej garancitë ligjore që i atribuohen të pandehurit dhe që paraqesin parakushte për një proces të drejtë penal.

Fusha e studimit të këtij disertacioni të doktoraturës është penale, respektivisht e procedurës penale, pasi që trajton ekskluzivisht të drejtat e të pandehurit, si një subjekt i rëndësishëm në kuadër të procedurës penale.

Siç u tha më sipër, çështja e marrë në studim lidhet ekskluzivisht me pozitën e të pandehurit në procedurën penale. Kjo nënkupton procedurën penale deri në përfundimin e saj me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Trajtimin në këtë disertacion të doktoraturës, kandidatja e ka shtruar në disa çështje thelbësore, që në fakt përbëjnë edhe përmbajtjen e temës.

Së pari, në kuadër të temës, kandidatja trajton aspektet e përgjithshme teorike dhe praktike të pozitës së të pandehurit në procedurën penale. Në këtë kuptim trajtohet përmbajtja e literaturës teorike që përcakton se cila është pozita e të pandehurit dhe ku qëndron rëndësia e mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit në një proces penal.

Së dyti, një dimension i rëndësishëm të cilin e trajton kandidatja në këtë disertacion të doktoraturës është mbrojtja juridike ndërkombëtare e të drejtave të të pandehurit, ky një dimension thelbësor për të garantuar të drejtën për një proces të drejtë penal.

Së treti, dimension kyç dhe në të cilin kandidatja e ka përqëndruar analizën kryesore të këtij disertacioni është pozita e të pandehurit në procedurën penale, në kuadër të rendit juridik të Republikës së Kosovës, ku i trajton në mënyrë të detajuar të gjitha garancitë juridike kushtetuese dhe ligjore që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të pandehurit në procedurën penale, në Republikën e Kosovës.

Detyrën shkencore në kuadër të këtij disertacioni të doktoratës, kandidatja e ka formësuar në bazë të pyetjeve kërkimore, në bazë të të cilave mëton të sqarojë në tërësi objektin e tezës së disertacionit. Pyetjet kërkimore mbi të cilat kandidatja e ka mbështetur këtë studim analitik janë:

1. Cila është rëndësia e mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit në procedurën penale dhe pse të drejtat e të pandehurit janë garanci për një proces të rregullt penal?
2. Cilat janë të drejtat që garantojnë pozitën e të pandehurit në procedurën penale në Republikën e Kosovës dhe sa ofron Sistemi Juridik i Republikës së Kosovës mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të pandehurit në procedurën penale?
3. Cili është statusi i Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës dhe çfarë ndikimi kanë vendimet dhe standardet e GJEDNJ-së ?

4. Sa zbatohen dhe sa respektohen në praktikën gjyqësore të drejtat e të pandehurit në procedurë penale në Republikën e Kosovës si dhe standardet që garantojnë ato?

Brenda këtyre pyetjeve kërkimore dhe detyrës shkencore, kandidatja ka ndërtuar analizën mbi objektin e studimit të temës.

Këtë disertacion të doktoraturës kandidatja e ka mbarështuar në pjesën hyrëse, dy pjesë dhe pesë kapituj.

Në pjesën hyrëse, kandidatja ka trajtuar rëndësinë e temës se marrë në studim duke u bazuar në argumente shkencore. Në këtë pjesë kandidatja parashton pyetjet kërkimore mbi të cilat e mbështet analizën e këtij disertacioni. Gjithashtu, në kuadër të pjesës hyrëse kandidatja paraqet edhe metodat shkencore mbi të cilat e ka mbështetur punën e saj studimore.

Në pjesën e parë të këtij disertacioni kandidatja trajton tri dimensione të ndarë në tre kapituj. Në kapitullin e parë, kandidatja trajton aspektin teorik të përcaktimit të të drejtave të të pandehurit në kuadër të procedurës penale, duke iu referuar statusit që ka i pandehuri gjatë zhvillimit të procedurës penale. Në kuadër të këtij kapitulli trajtohen të arriturat shkencore nga fusha e të drejtës së procedurës penale si shkencë, të arritura këto që kanë reflektuar në rregullimin normativ të statusit të të pandehurit. Kandidatja ka argumentuar që zhvillimi i teorive shkencore nga fusha e procedurës penale ka luajtur një rol të rëndësishëm në evoluimin e procedurës penale.

Natyrisht që rëndësia e kapitullit të parë qëndron në analizën teorike të statusit të të pandehurit në procedurë penale dhe ndikimin e zhvillimeve teorike në përmirësimin e pozitës së të pandehurit. Përmes këtij kapitulli, kandidatja ka arritur që të argumentojë se në zhvillimin e procedurës penale moderne, ka një mbizotërim të theksuar të tendencës së procedurës penale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në procedurë, përballë tendencës për efikasitet të procedurës.

Një dimension të veçantë në kuadër të këtij kapitulli paraqet trajtimi i primeve të procedurës penale që ndërlidhen me të drejtat e të pandehurit në procedurë penale dhe rëndësia e tyre në përcaktimin e statusit të të pandehurit në procedure penale.

Natyrisht që përmes këtij kapitulli kandidatja ka arritur të paraqesë shqyrtimet teorike të cilat kanë një rol shumë të rëndësishëm në argumentimin e çështjes së marrë në studim sepse vet zhvillimet teorike nga fusha e procedurës penale kanë luajtur rol mjaft të rëndësishëm në

humanizimin e të procedurës e penale përgjithësi dhe në mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit në veçanti.

Në kapitullin e dytë të pjesës së parë, kandidatja ka trajtuar aspektin historik të të drejtave të të pandehurit, përkatësisht evoluimin e statusit të të pandehurit përgjatë historisë. Në mënyrë kronologjike kandidatja ka arritur ta analizoj pozitën e të pandehurit në kuadër të procedurës penale dhe atë duke filluar nga periudha skllavopronare, vazhdon me periudhën feudale dhe deri tek zhvillimi i të drejtave të të pandehurit në kohën moderne. Në kuadër të këtij kapitulli, në mënyrë analitike është trajtuar statusi i të pandehurit në kontekst me rrethanat shoqërore dhe politike të secilës periudhë.

Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja ka trajtuar edhe aktet e para ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat në mënyrë direkte apo indirekte kanë reflektuar edhe në statusin e të pandehurit në procedurë penale, duke vendosur kështu themelet e mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit.

Përmes këtij kapitulli, kandidatja ka arritur që të paraqesë zhvillimin historik të të drejtave të të pandehurit, përkatësisht evoluimin e statusit të të pandehurit, ku krijohet një pasqyrë e qartë mbi përmirësimin e pozitës së të pandehurit në procedurë penale, nga objekt në subjekt të procedurës penale.

Në kuadër të këtij kapitulli, të drejtat e të pandehurit, kandidatja i ka trajtuar në mënyrë të pandashme nga të drejtat e njeriut, duke argumentuar lidhshmërinë që kanë të drejtat e njeriut njëra me tjetrën në aspektin e zbatueshmërisë së tyre dhe për faktin se të drejtat e të pandehurit janë dimension i veçantë i të drejtave të njeriut.

Rëndësia e kapitullit të dytë, qëndron pikërisht te pasqyrimi kronologjik i pozitës së të pandehurit në procedurë penale, ku një rol të rëndësishëm kanë pasur edhe zhvillimet shoqërore dhe politike, të cilat kanë ndikuar edhe në shkallën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht të pandehurit. Natyrisht, përmes këtij kapitulli kandidatja arrin të argumentojë qartë pozitën dhe të drejtat e të pandehurit përgjatë historisë dhe rrjedhimisht evoluimin e këtyre të drejtave deri në ditët e sotme.

Në kapitullin e tretë të kësaj teze të doktoraturës, kandidatja trajton aspektin ndërkombëtar të të drejtave të të pandehurit, duke iu referuar akteve ndërkombëtare për drejtat e njeriut në kuadër të të cilave përcaktohen edhe të drejtat e të pandehurit si kategori e veçantë e të drejtave të njeriut, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, etj.

Përmes këtij kapitulli, kandidatja ka arritur të analizoj kuadrin ligjor ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, përkatësisht për të drejtat e të pandehurit, duke zbërthyer dhe analizuar normat e akteve ndërkombëtare që prekin të drejtat e të pandehurit, të cilat në njërin anë kanë krijuar bazën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit dhe në anën tjetër kanë krijuar detyrim për shtetet që të sigurojnë zbatimin e tyre.

Po ashtu, në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja trajton edhe mekanizmat ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit dhe për garantimin e zbatimit të akteve ndërkombëtare, ku një vend të posaçëm zë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe roli i saj në mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit.

Ndër të tjera, në kuadër të këtij kapitulli trajtohen edhe rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në kontekst të garantimit të drejtave të të pandehurit dhe mbrojtjes së tyre. Përmes analizës së rasteve në të cilat GJEDNJ, ka identifikuar shkelje të të drejtave të të pandehurit, kandidatja ka arritur të argumentojë rolin dhe rëndësinë që ka praktika e krijuar nga GJEDNJ në mbrojtjen e lirive dhe të të pandehurit.

Gjithashtu, përmes këtij kapitulli kandidatja ka paraqitur garancitë ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e të pandehurit në procedurë penale dhe raportin e tyre me aktet e brendshme dhe obligimet e shteteve për t'i respektuar këto garanci me qëllim të sigurimit të një procesi të rregullt gjyqësor.

Përmes këtij kapitulli, kandidatja ka pasqyruar rëndësinë e akteve ndërkombëtare dhe praktikës së GJEDNJ, në raport me zbatimin e të drejtave të të pandehurit, përkatësisht zbatimin e të drejtës për gjykim të drejtë.

Pjesën e dytë e këtij disertacioni, të titulluar Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale në rendin juridik të Republikës së Kosovës kandidatja e ka ndarë në dy kapituj.

Në kapitullin e parë të kësaj pjese, kandidatja, arrin të analizoj çështjen kyçe të këtij disertacioni, ku në mënyrë analitike trajton statusin e të pandehurit në procedurën penale në Republikën e Kosovës. Përmes këtij kapitulli, pasqyrohen qartë garancitë juridike që ofron Republika e Kosovës për të garantuar një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm.

Në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja ka analizuar në mënyrë të detajuar të drejtat e të pandehurit në procedurë penale, ku duke respektuar hierarkinë e akteve juridike fillimisht i ka trajtuar të drejtat që garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe pastaj garancitë që ofron Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja arrinë të argumentojë edhe pytjen kërkimore që lidhet me garancitë që ofron Republika e Kosovës për të pandehurin në procedurë penale.

Duke analizuar garancitë kushtetuese të të pandehurit, kandidatja ka arritur të zbërthejë frymën demokratike të Kushtetutës së Kosovës, e cila përmban norma kushtetuese të cilat në mënyrë direkte prekin të drejtat e të pandehurit dhe paraqesin bazë për një gjykim të drejtë.

Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja ka bërë një analizë të detajuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të cilat rregullojnë pozitën e të pandehurit në procedurë dhe atë në formë të parimeve procedurale dhe përmes numërimit taksativ të të drejtave që i pandehuri i gëzon gjatë fazave të zhvillimit të procedurës penale, duke ndjekur rrjedhën e procedurës penale nga të qenit i dyshuar, i pandehur dhe i akuzuar.

Një dimension të rëndësishëm të cilin e trajton kandidatja në kuadër të kapitullit të dytë paraqet analiza e garancive juridike që ofrojnë aktet ndërkombëtare përkitazi me të drejtat e të pandehurit dhe zbatueshmëria e tyre në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, çështje kyçe në këtë kapitull paraqet edhe zbatueshmëria e drejtpërdrejt e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe akteve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, ku edhe pse Republika e Kosovës nuk është palë aktive në GJEDNJ, e njëjta ka marrë obligim kushtetues zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë dhe gjithashtu ka marrë obligim që të njëjtat të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ. Përmes këtij dimensionit të studimit, kandidatjam ka arritur të

zbërthejë statusin që ka KEDNJ dhe ndikimin që kanë vendimet dhe standardet e GJEDNJ në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të pjesës së dytë, në kapitullin e dytë kandidatja trajton aspektin e zbatimit praktik të të drejtave të të pandehurit në rendin juridik të Republikës së Kosovës. Një dimension të rëndësishëm në kuadër të këtij kapitulli, kandidatja ia kushton rolit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në mbrojtjen e të drejtave të pandehurit në procedurë penale, natyrisht kjo si instancë e fundit për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, meqenëse rastet nuk mund të adresohen në GJEDNJ. Në kuadër të këtij dimensionit analizohen rastet konkrete për të cilat ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Kosovës, përkitazi me shkeljen e të drejtave të të pandehurit në procedurë penale.

Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli, një pjesë të veçantë të analizës, kandidatja ia kushton praktikës gjyqësore përkitazi me zbatimin e të drejtave të të pandehurit në procedurë penale, ku analizohen shkalla e respektimit të të drejtave të pandehurit në procedurë penale dhe sfidat me të cilat përballen gjykatat në praktikë. Përmes këtij dimensionit, kandidatja, argumenton pyetjen kërkimore në lidhje me shkallën e zbatimit praktik të të drejtave të të pandehurit në Republikën e Kosovës.

Padyshim që pjesa e dytë paraqet pjesën kryesore, përmes të cilës kandidatja ka arritur që të analizojë në mënyrë të thuktë çështjen e marrë në studim në këtë tezë të doktoratës.

Në pjesën e fundit të këtij disertacioni kandidatja ka arritur të nxjerrë konkluzionet përkitazi me pyetjet kërkimore të shtruara më lart. Natyrisht, që përmes këtyre konkluzioneve kandidatja ka arritur t'u jap përgjigje pyetjeve kërkimore dhe të argumentojë rëndësinë që ka garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të të pandehurit në procedurë penale.

Gjithashtu, në bazë të të gjeturave nga ky studim, kandidatja ka arritur të nxjerrë edhe disa rekomandime të cilat kanë për qëllim që t'u shërbejnë autoriteteve të Republikës së Kosovës për përmirësimin e gjendjes në praktikën gjyqësore, përkitazi me respektimin e të drejtave të të pandehurit.

□ **Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni**

Disertacioni i doktoratës “Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale-Rasti i Kosovës”, paraqet një temë e cila në mënyrë të përmbledhur trajton statusin e të pandehurit në procedurë penale. Një temë e tillë në mënyrë të përmbledhur nuk është trajtuar mjaftueshëm më parë, edhe pse dimensione të caktuara të të drejtave të pandehurit janë pjesë e trajtimit të librave universitar, punimeve shkencore, analizave të ndryshme të cilat sjellin një pasqyrë shumë dimensionale për pozitën e të pandehurit në procedurën penale.

Trajtimi i të drejtave të të pandehurit në procedurë penale më shumë është shtjelluar nga autorët në hapësirën ndërkombëtare, kryesisht përmes analizave të ndryshme, por edhe përmes punimeve që prekin dimensione të veçanta të të drejtave të pandehurit.

Në hapësirën shqiptare, kjo temë më shumë është e shtjelluar në kuadër të librave universitar, sesa në kuadër të punimeve specifike shkencore. Trajtimet kryesore të të drejtave të pandehurit në procedurën penale, në hapësirat shqiptare janë bërë kryesisht në tekstet e të drejtës penale dhe të së drejtës penale procedurale, mirëpo një trajtim i tillë është më shumë i natyrës pedagogjike se sa i natyrës së thellë analitike.

Po ashtu, të drejtat e të pandehurit në hapësirën shkencore shqiptare janë elaboruar edhe në kuadër të së drejtës kushtetuese, saktësisht në dimensionin e të drejtave të njeriut. Në hapësirën shqiptare së fundi janë ofruar edhe punime që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në përgjithësi, duke përfshirë këtu çështje që kanë të bëjnë me vendimet e GJEDNJ-së. Ndër autorët kryesorë të hapësirave shqiptare që janë marrë me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe disa dimensione të të drejtave të të pandehurit në procedurë penale janë: Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Ismet Salihu, Fatmire Lumani, Arsim Bajrami, Qerim Qerimi, Gjylieta Mushkolaj, Hazër Susuri etj.

Ndër autorët e shumtë ndërkombëtar që kanë trajtuar dimensionet e veçanta të të drejtave të pandehurit në procedurën penale janë: Paul Mahoney, Piero Leanza & Ondrej Pridal, Akhil Reed Amar, Brooks Holland, Roberta K. Flowers, David Weissbrodt, Jeremy McBride, Margareth Etienne, Asher Flynn, Jacquelin Hodgson, Jude McCulloch, dhe Bronwyn Naylor, etj.

Çështja e të drejtave të të pandehurit, në kuptim specifik përpos në punime shkencore, në masë të madhe është objekt trajtimi edhe në kuadër të raporteve të ndryshme të institucioneve ndërkombëtare, siç është Këshilli i Evropës.

Gjithashtu, shtjellimi i të drejtave të të pandehurit në prizmin e praktikës së GJEDNJ, është elaboruar më shumë, sidomos në kuadër të raporteve të ndryshme duke marrë parasysh rëndësinë që kanë vendimet dhe praktika e GJEDNJ për të drejtën ndërkombëtare, por edhe për të drejtën e brendshme.

Prandaj, mund të themi se me anë të kësaj teze të disertacionit të doktoratës, kandidatja ka arritur të analizojë në mënyrë të detajuar të drejtat e të pandehurit.

□ **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura**

Tema e hulumtimit të kësaj teze të doktoratës është kualitative- cilësore, pasi që problemet e shtruara në kuadër të temës analizohen bazuar në një prizëm të përgjithshëm në dy drejtime kryesore siç janë: mbrojtja e të drejtave të pandehurit në procedurën penale dhe rëndësia e kësaj mbrojtje si dhe praktika dhe vendimet e GJEDNJ dhe standardet që kanë krijuar këto vendime. Këto dy çështje në veçanti dhe tema në tërësi trajtohen, duke mos u kufizuar në numër të caktuar të rasteve.

Për trajtimin dhe hartimin e kësaj teze të doktoratës, kandidatja, ka përdorur metoda të pranueshme shkencore. Metodat kryesore të cilat janë përdorur për hartimin e temës janë: metoda historike, metoda analitike, metoda dogmatike, metoda e rasteve dhe metoda krahasuese. Secila metodë është përdorur për çështje të caktuara dhe në pjesët e caktuara të temës.

Kështu, metoda historike është përdorur për vështrimin historik të çështjes së trajtimit të kësaj teze. Përdorimi i kësaj metode me së shumti vjen në shprehje në kuadër të kapitullit të dytë në të cilin trajtohet aspekti historik i zhvillimit të të drejtave të njeriut. Përmes kronologjisë historike kandidatja ka pasqyruar rrjedhën e zhvillimi të të drejtave të të pandehurit.

Metodën analitike, kandidatja e ka përdorur për analizën e çështjes kyçe të këtij, ku padyshim që në masë të madhe vjen në shprehje në kuadër të pjesës së dytë të temës. Metoda analitike është përdorur sidomos gjatë analizimit të rezultateve të temës si dhe komentimit të të gjeturave. Po ashtu kjo metodë vjen në shprehje edhe tek konkluzionet e temës.

Përmes metodës dogmatike, kandidatja, ka arritur të bëjë komentimin dhe analizimin e akteve ndërkombëtare dhe kombëtare që kanë të bëjnë me pozitën e të pandehurit në procedurën penale, respektivisht të drejtat e tij, ku thelbësore është zbërthimi dhe interpretimi i normave juridike të cilat garantojnë të drejtat e të pandehurit.

Metoda e rasteve dhe përdorimi i saj gjatë analizimit të objektit të kësaj teze të doktoratës ka gjetur vend gjatë analizimit të vendimeve të ndryshme të GJEDNJ-së, ku janë paraqitur specifikat e secilit rast dhe relevanca e fakteve të atij rasti mbi argumentet që ndërtohen lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pandehurit. Gjithashtu, këtë metodë kandidatja e ka përdorur edhe në analizën e rasteve konkrete për të cilat Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ka vendosur se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.

Metodë tjetër e rëndësishme që është përdorur në kuadër të tezës është ajo krahasimore, me anë të së cilës kandidatja ka bërë krahasimin e sistemeve juridike dhe tërheqjes së paraleleve të caktuara sidomos me rastet praktike të GJEDNJ-së. Metoda krahasimore vjen në shkrehje sidomos në krahasimin e rasteve të ndryshme praktike, si dhe elementeve që janë të krahasueshme në kuadër të këtyre rasteve, që shprehin pozitën e të pandehurit në kuadër të procesit penal, në raport me aktet ndërkombëtare dhe ato të brendshme.

□ **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit**

Rezultatet e hulumtimit të këtij disertacioni korrespondojnë me pyetjet kërkimore të parashtruara me lartë e të cilat konsistojnë në këto pika:

- Se një proces i rregullt gjyqësor varet nga zbatimi të drejtave të të pandehurit në procedurën penale dhe;
- Se Sistemi Juridik i Kosovës ofron mjaft garanci, për sa i takon të drejtave të pandehurit në procedurën penale;
- Se përparësi e rëndësishme e Sistemit Juridik të Republikës së Kosovës, në kuptim të garancive për të drejtat e të pandehurit paraqet obligimi kushtetues për zbatimin e drejtpërdrejt të dispozitave të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ, kjo sa i përket rregullimit normativ;

- Se është mangësi në praktikën gjyqësore të gjykatave në Republikën e Kosovës, nuk mund të gjesht madje asnjë rast, ku gjyqtarët kanë aplikuar drejtpërdrejt dispozitat e KEDNJ apo ndonjë rast të GJEDNJ, sa i përket të drejtave të pandehurit;
- Se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përmes aktgjykimeve përfundimtare të saj, ka kompensuar lëshimet që kanë bërë gjykatat e rregullta në zbatimin e standardeve të KEDNJ.

Përfundim

□ Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Kontributi i këtij hulumtimi është konkret dhe ndërlidhet me çështjet si:

- Sqarimi i pozitës dhe statusit të të pandehurit në procedurën penale në Sistemin Juridik të Republikës së Kosovës;
- Të drejtat e të pandehurit dhe rëndësia e të drejtave të të pandehurit në procedurën penale;
- Sqarimi i statusit të KEDNJ dhe vendimeve të GJEDNJ-së në Sistemin Juridik të Republikës së Kosovës;
- Ofrimi i një analize të saktë lidhur me vendimet më të rëndësishme të GJEDNJ-së sa i përket të drejtave të të pandehurit në procedurën penale;
- Të kuptuarit e standardeve të GJEDNJ-së lidhur me të drejtat e të pandehurit dhe ndikimin e këtyre standardeve të GJEDNJ-së lidhur me të drejtat e të pandehurit në Republikën e Kosovës si dhe efikasitetin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të pandehurit në Sistemin Juridik të Kosovës.
- Të kuptuarit e shkallës së zbatimit praktik të këtyre të drejtave në Republikën e Kosovës;
- Identifikimi i pengesave me të cilat përballet sistemi gjyqësor i Kosovës dhe ndikimi i tyre në shkeljen e të drejtave të të pandehurit.
- Formulimi i rekomandimeve drejtuar autoriteteve për zbatimin e garancive që i takojnë të pandehurit në procedurë penale dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e statusit të të pandehurit.

□ **Fushën shkencore në të cilën do të aplikohen**

Ky disertacion i doktoraturës i kandidatës Adelina Rakaj, paraqet një kontribut të ri dhe original për komunitetin juridik në përgjithësi si dhe për institucionet e drejtësisë në veçanti. Të gjeturat e këtij punimi, të mbështetura në studimin e praktikës gjyqësore të Republikës së Kosovës, do të gjejnë zbatim në fushën procedurale penale, përkatësisht në përmirësimin e pozitës së të pandehurit në procedurë penale, duke aplikuar garancitë juridike që përcaktojnë aktet ndërkombëtare dhe aktet e brendshme të Republikës së Kosovës.

□ **Hulumtime të mundshme të ardhshme**

Përkundër faktit se ky disertacion i doktoratës është mjaft i detajuar përkitazi me të drejtat e të pandehurit në procedurë penale në Republikën e Kosovës, në të ardhmen mbetet ende për t'u hulumtuar në këtë fushë, sidomos pasi Republika e Kosovës të bëhet palë aktive në GJEDNJ. Gjithashtu, mbetet për t'u hulumtuar në vazhdimësi shkalla e zbatimit praktik të të drejtave të të pandehurit në procedurën penale, përkitazi me rekomandimet ndërkombëtare për përmirësimet në zbatimin e të të drejtave të të pandehurit, sepse duket se mbetet sfiduese për gjykatat zbatimi i të drejtave të të pandehurit në procedurë penale.

□ **Përfundim me propozim**

Në bazë të asaj që u tha më lart, ne si Komision konsiderojmë që disertacioni me titull "Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale-rasti i Kosovës" i kandidatës Adelina Rakaj, i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e caktuara profesionale, shkencore dhe metodologjike.

Të gjithë anëtarët e Komisionit janë unik në vlerësimin se kjo tezë e disertacionit është punuar me përkushtim dhe profesionalizëm si dhe sjell rezultate të reja shkencore të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin e statusit aktual të të pandehurit në procedurë penale përkitazi me të drejtat që i takojnë dhe domosdoshmërisë për marrjen e masave për përmirësimin e shkallës së zbatimit të këtyre të drejtave në të ardhmen.

Me këtë propozim përfundimtar, ne si anëtarë të Komisionit, vlerësojmë se kandidatja Adelina Rakaj, ka përgatitjen e duhur për mbrojtjen e tezës së disertacionit me titull: "Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale-rasti i Kosovës".

Prandaj, ne si Komision i rekomandojmë Këshillit Mësimor të Fakultetit Juridik, që të miratoj këtë raport final të këtij disertacioni.

KOMISIONI:

1. Prof.Dr. Afrim Osmani, Kryetar,

2. Prof.Dr. Qebir Avziu, Anëtar,

3. Prof.Dr. Arta Bilalli, Anëtare,

4. Prof.Dr. Jusuf Zejneli, Anëtar

5. Prof.Dr. Fatmire Lumani, Mentore,
